



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.887/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Vlora Mehmeti nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare “Ne Mundemi” me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.887/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Vlora Mehmeti nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi me seli në Ferizaj.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Malishevës, nga radhët e Subjektit Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi, me seli në Ferizaj, në vendvotimet: VV 2501X/05R, VV VV 2521D/01R, VV 2502X/01R, VV 2502X/02R, VV 2517D/02D, VV 2534D/02D, VV 2502D/05R dhe VV 2501Y/12R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Vlora Mehmeti nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi me seli në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në vendvotimet: 2521D/01D, 2517D/02D dhe 2501D/05R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Vlora Mehmeti nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi me seli në Ferizaj ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve VV 2501X/05R, VV VV 2521D/01R, VV 2502X/01R, VV 2502X/02R, VV 2517D/02D, VV 2534D/02D, VV 2502D/05R, VV 2501Y/12R, 2521D/01D, 2517D/02D dhe 2501D/05R për arsye se në këto vendvotime ka pasur shkelje sepse nuk i kanë dalë votat për të cilat është votuar.

Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e 14 votueseve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Vlora Mehmeti nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi me seli në Ferizaj, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet VV 2501X/05R, VV 2521D/01R, VV 2502X/01R, VV 2502X/02R, VV 2517D/02D, VV 2534D/02D, VV 2502D/05R, VV 2501Y/12R, 2521D/01D, 2517D/02D dhe 2501D/05R.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Vendvotimeve, të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara, kandidatet për kuvend komunal Vlora Mehmeti ka vetëm 2 vota, ndërsa sipas deklaratave të 14 votueseve të bashkangjitura në apel e që ndërlidhen me këto VV, deklarojnë se kanë votuar të njëjtën mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratata e votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.887/2021 më datën 06.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.